



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 6278 / Prot.

Tiranë, më 27.08. 2026

UDHËZIM

Nr. 16, datë 27.08. 2026

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 14, DATË 10.07.2023,
“PËR NUMRIN E NXËNËSVE PËR KLASË DHE NGARKESËN MËSIMORE TË
PUNONJËSVE ARSIMORË NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR”, I
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “d” të pikës 2 të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe urdhrin nr. 578, datë 11.11.2025, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit, znj. Orjana Osmani”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 14, datë 10.07.2023, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar, të bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:
 - a) Nën-pika “iii” e shkronjës “a” të pikës 2 të kreut II ndryshon si më poshtë:
“iii. Tri klasa, kur numri i nxënësve është 21–30”.
 - b) Pas nën-pikës “iii” të shkronjës “a” të pikës 2 të kreut II shtohet nën-pika “iii/1” me këtë përmbajtje:
“iii/1. Katër klasa, kur numri i nxënësve për klasë është 31–50”.
 - c) Kudo në pikën 3 të kreut II togfjalëshi “se 80” zëvendësohet me “se 60”
 - ç) Në shkronjën “c” të pikës 4 të kreut II, pas togfjalëshit “mësuesi në shkollat e arsimit special” shtohet togfjalëshi “mësuesi i artit pamor, mësuesi i edukimit muzikor”.
 - d) Pas shkronjës “c” të pikës 4 të kreut II shtohet shkronja “c/1” me këtë përmbajtje:
“c/1. Mësuesi i lëndës Edukim fizik dhe sporte: 21 orë në javë”.

dh) Në pikën 4 të kreut II, pas fjalisë *“Drejtori dhe nëndrejtorët e shkollës e plotësojnë normën mësimore javore vetëm me orë të profilit të diplomës që zotërojnë.”*, shtohet paragrafi me përmbajtjen si vijon:

“Drejtori/nëndrejtori i shkollës që është i profilit të arsimit fillor mund ta plotësojë ngarkesën mësimore javore edhe me orë mësimore të përcaktuara në Kreun V të këtij udhëzimi”.

e) Në shkronjën “f”, të pikës 4, të kreut II togfjalëshi *“me 81”* zëvendësohet *“me 61”*.

ë) Në shkronjën “a”, të pikës 5, të kreut II, togfjalëshi *“me 81”* zëvendësohet *“me 61”*.

f) Shkronja “a” e pikës 2, të kreut III ndryshon si më poshtë:

“a) Kur numri i nxënësve është më shumë se 60, emërohet një drejtor shkolle”.

g) Pas shkronjës “b” të pikës 3 të kreut III shtohet shkronja “b/1” me këtë përmbajtje:

“b/1. Mësuesi i lëndës Edukim fizik dhe sporte: 21 orë në javë”.

gj) Në shkronjën “d”, të pikës 3, të kreut III, togfjalëshi *“me 81”* zëvendësohet *“me 61”*.

h) Në shkronjën “a”, të pikës 4, të kreut III, togfjalëshi *“me 81”* zëvendësohet *“me 61”*.

i) Shkronja “a” e pikës 2 të kreut IV ndryshon si më poshtë:

“a) Kur numri i nxënësve është më shumë se 60, emërohet një drejtor shkolle”.

j) Në shkronjën “f” të pikës 3, të kreut IV pas togfjalëshit *“Dega Balet”*, të shtohet togfjalëshi *“, lëndët: Repertor, Teknikë Djem, Puante Vajza, Balet Modern, Valle Popullore, Duet Klasik.”*.

k) Shkronjat “g” dhe “h” të pikës 3, të kreut IV ndryshojnë si më poshtë:

“g) Drejtori i shkollës me 61–200 nxënës: 6 orë në javë.

h) Drejtori i shkollës me 201–600 nxënës: 4 orë në javë”.

l) Në shkronjën “a”, të pikës 4, të kreut IV, togfjalëshi *“me 81”* zëvendësohet *“me 61”*.

ll) Pas shkronjës “a” të pikës 6 të kreut IV shtohet shkronja “a/1” me këtë përmbajtje:

“a/1) Orët e lëndës Formim Praktik Profesional për specialitetin “Futboll” ndahen në grupe “Lojtarët” dhe “Portierët”. Grupi i lojtarëve formohet me nxënës të të njëjtit nivel arsimor. Grupi i “Portierëve” formohet me jo më pak se 6 nxënës të të njëjtit nivel arsimor”.

m) Pika 18 e kreut V shfuqizohet.

n) Në kreun V, pas pikës 31, shtohen pikat 32, 33 dhe 34 me përmbajtje si më poshtë:

“32. Kryetari të ekipit lëndor i ulet norma mësimore me 2 orë në javë.

33. Mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë e ka normën mësimore 6–10 orë në javë;

mësuesi koordinator i këshillimit të karrierës e ka normën mësimore 8–12 orë në javë.

34. Drejtori ose nëndrejtori i ngarkuar me organizimin dhe monitorimin e programit “Pas shkolle”, të ketë ulje në normën mësimore javore në varësi të numrit të grupeve/klubeve, si më poshtë:

a) 2 orë mësimore në javë, kur institucioni ka deri 4 grupe ose klube.

b) 4 orë mësimore në javë, kur institucioni ka mbi 4 grupe ose klube.”

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR

ORJANA OSMANI

